



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr. 61/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi - kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 31.12.2025, merr këtë :

VENDIM

KONSTATOHET TËRHEQJA e ankesës e parashtruar nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, ZP. A.nr.61/2025, e datës 30.12.2025, të paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Sjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 28 Dhjetor 2025.

Arsyetim

Më datë 30.12.2025 në PZAP-i, është pranuar një ankesë parashtruar nëpërmjet Postës së Kosovës me datë 23.12.2025 nga subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), , në të cilën pretendohet se me datë 22.12.2025 subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka vendosur disa postera me foto partiake dhe përmbajtje zgjedhore dhe elektorale në sheshin Dëshmorët e Kombit Ferizaj, pra në një hapësirë publike, rrjedhimisht me këtë veprim ka shkelur nenin 34, par. 2 të LZP-së, i cili parasheh që vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve, është e ndaluar. Subjekti në fjalë ka vendosur posterat e tyre në rrugë publike, rrjedhimisht me veprimin e tyre kanë konsumuar shkelje ligjore sipas nenit 34, par. 2. Andaj, kërkojmë nga ana e PZAP, që

duke u mbështetur në kompetencat e tyre të shqyrtojnë këtë ankesë dhe të marrin një vendim merititor. Si dëshmi ka bashkangjitur 3 fotografi si provat materiale.

Po ashtu më datë 30.12.2025, ankuesi ka parashtruar kërkesën me Nr. Protokolli ZP. A.nr.61-3/2025 për tërheqjen e ankesës së lartcekur në të cilën thekson se në web faqen zyrtare të PZAP tek statusi i rastit kanë vërejtur një ankesë në emër të PDK-së e bërë kundër LVV-së me m. 61, komuna Ferizaj, për të cilën ankesë nuk janë në dijeni të kësaj ankese, dhe personi që e ka bërë këtë ankesë e ka bërë pa autorizimin e subjektit politik PDK dhe për të njëjtën kërkojnë nga PZAP-i që të ja lejoj tërheqjen e kësaj ankese.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 11 paragrafi 8 i Rregullores nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-së, si dhe nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.61/2025, datë 31.12..2025

